



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

PËR OBJEKTIN ;

“Supervizion Mirëmbajtje me Performance të Rugëve Rajoni Verior,
Qendror dhe Jugor”

TIRANË 2020

1. Hyrje

1.1 Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Rrugor Shqiptar (A.Rr.Sh) do të jetë Autoriteti Kontraktues.

1.2 Organizimi dhe Menaxhimini i projektit

Institucioni përgjegjës për politikat e transportit në Shqipëri është Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është Agjensia përgjegjëse për menaxhimin dhe implementimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe nëpërmjet Drejtoreve të Rajoneve ka planifikuar të implementojë Kontratat e Mirëmbajtjes me Bazë Performance, mbi një marrveshje kuadër 4 vjeçare, për rrjetin rrugor kombëtar si dhe për Menaxhimin e tyre nëpërmjet Kontratës së Mbikqyrjes në për çdo rajon:

1.3 Informacion

Ashtu si në shumë vende të Europës Lindore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Shqipëri ka vuajtur nga investimet e pakta, gjatë disa dekadave të kaluara. Kjo ka sjellë si rezultat degradimin e rrugëve ekzistuese, mirëmbajtje të pamjaftueshme e cila ka qenë e shoqëruar edhe nga pamjaftueshmëria e përgjigjes ndaj rritjes së volumit të trafikut që ka gjeneruar pas viteve '90. Vitet e fundit një numër rrugësh janë rehabilituar dhe rrugë të tjera janë ende në proces rehabilitimi ose përmirësimi. Krijimi i sistemeve të përmirësimit dhe standardeve të mirëmbajtjes është i rëndësishëm me qëllim sigurimin e faktit që përmirësimet e rrjetit janë të qëndrueshme.

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë masat për rritjen e eficiencës së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar. Në një linjë me këtë strategji, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar (Drejtoreve të Rajoneve) ka propozuar implementimin e kontratave bazuar në performance si dhe menaxhimin e tyre nëpërmjet Kontratave të Mbikqyrjes.

1.4 Koncepti i Kontratave me bazë Performancë

Ky tip kontratash kërkon që sektori privat të marrë përgjegjësitë për menaxhimin e aseteve rruvore në këmbim të një pagesë mujore fiksë, e cila është subjekt i zbritjeve (penaliteteve) që lidhen me dështimin përfundimtar detyrimet e mirëmbajtjes.

Kontratat e mirëmbajtjes me bazë performance përpilen të adresojnë çështjet në drejtim të kontraktorëve duke specifikuar punët dhe shërbimet që do të kryhen me qëllim arrijet e mirëmbajtjen e Niveleve të Shërbimit të përcaktuara në Kontratë. Gjatë procesit të tenderimit Kontraktorët propozojnë një shumë fiksë pagesë mujore e shprehur në lekë/km/muaj në këmbim të kryerjes së punës përmirëmbajtjen, me qëllim mbajtjen e rrugës sipas Niveleve të shërbimit të përcaktuara. Kur rrugët që janë planifikuar të mirëmbahen nuk janë në nivelet e kërkua të atëherë një pagesë shtesë aplikohet, me qëllim mbulimin e punimeve fillestare përfundimtar detyrimet e mirëmbajtjes. Është e rëndësishme të kuptohet që, kontraktorët nuk paguhen direkt përfundimtar "inputet" ose punimet fizike që kryejnë, (të cilat ato padyshim kanë përfundimtar detyrimet që ti kryejnë) por përfundimtar "outputet" rezultatet nga puna e kryer. Si prash. kryerja e punimeve të rehabilitimit përfundimtar detyrimet që ti kryejnë).



paracaktuara (nëse kjo kërkohet) ndiqet nga një mirëmbajtje e rregullt rutinë e rrugës për të siguruar dhe mbajtur standartet e përcaktuara.

Në kontratat me Bazë Performancë, të cilat janë edhe subjekt i monitorimit nën këtë **kontratë Mbikqyrjeje**, kontraktori do të kryejë një numër aktivitetesh (pune dhe shërbimi) me qëllim që të arrijë të mirëmbajë në nivelin e kërkuar të shërbimit (N.Sh) për përdoruesit e rrugës në rrjetin rrugor që përfshin kontrata. Në mënyrë specifike, punimet që do kryhen me kontratat e këtyre mirëmbajtjeve, janë :

- **Punimet e Rehabilitimit/Periodike të rrugëve**; punimet e rehabilitimit fillestar që kryhen gjatë 12 muajve të parë të kontratës me qëllim për të sjellë rrugën në standarte të caktuara, për të vijuar me punime periodike gjatë 3 viteve të tjera të kontratës. Këto punime i referohen të gjithë komponentëve të rrugës (drenazheve, punimeve të dheut, strukturave, shtresave asfaltike, elementëve të sinjalistikës, pajisjeve të sigurisë, veprave të artit, etj.) dhe duhet të mos kalojnë vlerën në masën 40% në raport me vlerën e kontratës. Punimet e Rehabilitimit/Periodike kryhen mbi bazën e skicave, vizatimeve dhe preventivave të hartuar nga Kontraktorët (me çmimet e ofertuara), aprovimin e supervizorit dhe miratimin e Autoritetit Kontraktor, me qëllim sjelljen e rrugës në kushte të pranueshme për të kryer një mirëmbajtje rutinë sipas nivelit të kërkuar të shërbimit, sipas një grafiku punimesh të miratuar. Punimet e rehabilitimit/periodike janë punime që parashikohen të kryhen me qëllim rinoimin e elementeve të ndryshëm të rrugës, pajisjeve rrugore si dhe rivendosjen dhe përmirësimin e cilësisë fillestare, të njëjtë, kur ato janë të rezikuara ose të dëmtuara seriozisht dhe përfshijnë punimet e mëposhtme :

- rinoimi i sipërfaqes së pjesës kaluese/karrehatës
- përmirësimi i sistemit të kullimit;
- parandalimin e erozionit të argjinaturës, rrëshqitjes së shkëmbinjve dhe vendosjen e sistemeve të mbrojtjes së nevojshme;
- riparimin e urave, apo veprave të artit, nëse sistemi strukturor dhe materialet nuk kanë ndryshuar;
- zëvendësimi i sinjalizimit dhe pajisjeve rrugore;
- gjeometrinë e një rruge duke zgjeruar ose riorganizuar atë;

Për të gjitha punimet e rehabilitimit fillestar që do të kryhen do të mbahet 5% garanci punimesh e cila do të çlirohet pas një viti nga përfundimi i punimeve nëse nuk ka vërejtje ose mangësi të konstatuara në secilin rast.

- **Mirëmbajtje rutinë**; janë punime që kryhen rregullisht me qëllim që të mirëmbahen kushtet bazë dhe funksionaliteti i rrjetit rrugor. Këto aktivitete janë:

- ✓ riparimi i defekteve të shtresave,
- ✓ mirëmbajtja e bankinave,
- ✓ mirëmbajtja e drenazheve,
- ✓ mirëmbajtja e strukturave,
- ✓ mirëmbajtja e skarpatave,
- ✓ mirëmbajtja e sinjalistikës dhe vijëzimeve,
- ✓ kontrolli i vegjetacionit,
- ✓ pastrimi i plehrave dhe vajrave në rrugë,
- ✓ përgjigjet ndaj aksidenteve, si dhe



- ✓ punimet e mirëmbajtjes dimërore.
- ✓ Mirëmbajtja e ndriçimit (aty ku ai ekziston)
- **Punimet emergjente** ; – janë aktivitete të nevojshme që duhet të kryhen për të risjellë rrugën në kushtet normale pas dëmtimeve të ndodhura përgjithësisht si rezultat i fenomeneve natyrorë të paparashikuara.

Kontratat e Mirëmbajtjes me Performancë do të përfshijnë gjithashtu normalisht, një element të dhënash bazuar në punën (si psh matje në ditë-pune) për të mbuluar mundësinë e punimeve të paparashikuara emergjente, të cilat kërkojnë një ndërhyrje të veçantë.

Tipari themelor i kontratës së bazuar në performancë është se Kontraktori është përgjegjës për projektimin, planifikimin dhe kryerjen e veprimeve që ai beson se janë të nevojshme në mënyrë që të përputhen me nivelet e cilësisë së shërbimit të përcaktuara në kontratë. Në qoftë se cilësia e shërbimit nuk është arritur në një muaj të caktuar, pagesa për atë muaj do të reduktohet nga një sasi proporcionale shuma e të cilave do të jetë deri në masën 30% e vlerës së Mirëmbajtjes Rutinë (në Ofertën e paraqitur) dhe në rast se bëhet më e madhe duhet të fillohen procedurat e propozimit për ndërprerjen e kontratës. Në një kontratë të bazuar në performancë, Kontraktuesi ka një nxitje të fortë financiare për të siguruar një nivel të pranueshëm të shërbimit në mënyrë më efikase. Në mënyrë që të maksimizojë fitimet, kontraktori duhet të ketë aftësi të mira të projektimit me qëllim zvogëlimin e aktiviteteve të tij me numrin minimal të ndërhyrjeve të projektuar në mënyrë inteligjente, të cilat, megjithatë, sigurojnë se rezultatet e para-përcaktuara (treguesit e matur të nivelit të shërbimit) janë arritur dhe mirëmbahen me kalimin e kohës.

Këto lloj kontratash kërkojnë një Kontraktor që të ketë kapacitete të mira të menaxhimit. Këtu, me "menaxhim" nënkuptohej aftësia për të përcaktuuar, zgjedhur dhe për të ndërmarrë në kohë ndërhyrjet fizike të cilat janë të nevojshme në një afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, në mënyrë që të garantojë se rrugët mbeten në ose mbi nivelet e dakordësuara të cilësisë së shërbimit. Me fjalë të tjera, brenda kufizimeve të vendosura nga Kontrata dhe nga nevoja që të përputhen me legjislacionin vendor, specifikimet teknike dhe rregulloret mjedisore dhe sociale, Kontraktuesi ka të drejtë të propozojë në mënyrë të pavarur:

(i) çfarë të bëjë; (ii) ku të bëjë atë; (iii) si t'a bëjë dhe (iv) kur ta bëjë

Në mënyrë që të ketë të drejtë për pagesën mujore për shërbimet e performancës së rrjetit rrugor (mirëmbajtje), Kontraktuesi duhet të sigurojë se rrugët në kontratë janë në përputhje me nivelet e cilësisë së shërbimeve të cilat janë të përcaktuara në dokumentet e tenderit (DST). Është e mundur që gjatë disa muajve, ai do të duhet për të kryer një sasi mjaft të madhe të punimeve fizike në mënyrë që të përputhen me nivelet e kërkua të shërbimit dhe shumë pak punë gjatë muajve të tjerë. Megjithatë, pagesa e tij mujore mbetet e njëjtë për sa kohë që nivelet e kërkua të shërbimit janë në përputhje me ato të përcaktuara në DST. Pajtueshmëria me nivelet e shërbimit është e bazuar në vlerësimet mujore të një shumëlojshmërie të parametrave të mirëmbajtjes të cilat mund të përfshijnë :

- Përdorshmërinë e rrugës dhe disponueshmërinë e saj;
- Kushtet e sipërfaqes së rrugës (plasaritje, gropë, rezistenca në rrëshqitje);
- Ashpërsia/rrudhshmëria e rrugës;
- Thyerja/dëmtimi i anëve të asfaltit;



- Gjendja e bankinave;
- Vijëzimet;
- Sinjalistika;
- Funksionaliteti i drenazheve;
- Bimësia;
- Ndriçimi;
- Gjendja e strukturave;

Kontraktori do të krijojë një organizim të qëndrueshëm për të kontrolluar kryerjen e punëve që duhet të bëhen në përputhje me të gjitha rregulloret ekzistuese që mbulojnë mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe në përputhje me Standartet e projektimit dhe ndërtimit të Rrugëve në Shqipëri.

Veçanërisht Kontraktori, është e nevojshme :

- i) ***të krijojë***, duke përdorur një personel të miratuar, përgjegjëse për monitorimin e nivelit të shërbimit dhe për të siguruar që ato janë plotësuar, si dhe monitorimin e cilësisë së punimeve për tu siguruar që të gjitha punimet janë ekzekutuar duke përmbrushur standartet në fuqi.
- ii) ***të përgatisë***, në fillim, një Plan Sigurimit të Cilësisë, për të përcaktuar procesin përmes të cilit do të përmbushen kërkesat e cilësisë së kontratës
- iii) ***të përgatisë*** një plan shëndetësor të menaxhimit dhe sigurisë, për të përcaktuar se si pajtueshmëria me të gjitha kërkesat përkatëse të shëndetit dhe sigurisë në punë do të plotësohen dhe monitorohen.
- iv) ***të përgatisë*** procedurat e emergjencës dhe planin e emergjencës për të përcaktuar se si ai do të përgjigjet për ngjarjet emergjente. Kjo do të mbulojë dy emergjencia: të trafikut dhe emergjencat natyrore të tillë si bllokime nga përblytjet, rrëshqitjet apo dëbora etj.

Në përgjithësi një Kontraktues kompetent duhet të jetë i aftë në menaxhimin e kontratës në të gjitha aspektet e saj dhe të përgatisë raportet përkatëse.

1.5 Një përshkrim i shkurtër i Kontratave Tip Performance

Duke marrë në konsideratë faktin që ky projekt aplikohet në një rrjet rrugor që ka disa standarte siç janë: rrugë të reja, të rikonstruktua ose edhe rrugë në gjendje jo të mirë (pa asfalt, me çakull), është e domosdoshme që fillimi shi, ky rrjet rrugor, të sillet në një nivel standarti të pranueshëm për aplikimin e mirëmbajtjes rutinë, dhe më tej, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara për atë nivel shërbimi.



Bazuar në këto pikëpamje Mbikqyrësi i Punimeve, do të angazhohet për të siguruar një Mbikqyrje efektive të punimeve të mirëmbajtjes, për monitorimin dhe çertifikimin e punimeve, (pavarësisht nëse shtohen apo pakësohen kilometrat në administrim të kësaj Drejtorie) :

- (i) Punime të rehabilitimit fillestar dhe punimet periodike
- (ii) Punimet e mirëmbajtjes rutinë (duke përfshirë edhe ato dimërore)
- (iii) Kryerja e punimeve emergjente (sa herë që paraqitet e domosdoshme)

2. OBJEKTIVAT, FUSHA E SHËRBIMIT

2.1 Objektivat e shërbimit

Objektivat themelore të shërbimeve të Mbikqyrësit do të janë:

- Për të ndihmuar Autoritetin Kontraktor me qëllim kryerjen e detyrës së administritimit të kontratave të Mirëmbajtjes me Performancë sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar” (dhe Udhëzimet përkatëse), gjatë zbatimit të projektit.
- Për të siguruar një staf prej inxhinierëve të kualifikuar dhe profesionistë të tjerë, duke qenë kompetent në kryerjen e të gjitha detyrave të mbikëqyrjes, në bazë të përgjegjësive dhe të kompetencave që do të delegohen nga Autoriteti Kontraktor.
- Për të siguruar kontratën duke verifikuar se nivelet e Shërbimit të dakordësuara janë përm bushur, si dhe i gjithë legjislacioni tjeter dhe rregulloret janë respektuar.

2.2 Fusha e shërbimit

2.2.1 Implementimi i Kontratave të Mirëmbajtjes me Bazë Performance

Niveli i Shërbimit është një koncept, që nuk mund të matet drejtpërdrejt, ai zakonisht përcaktohet përmes kritereve të masave të performancës. Masat e performancës janë të lidhura me karakteristikat e ndryshme të rrugëve, si dhe shërbimet menaxheriale.

Për këtë qëllim, një seri e treguesve të performancës janë të përcaktuara në specifikime, të cilat janë në gjendje të maten dhe të renditen numerikisht. Kjo është pajtueshmëria me vlerat e kërkua të tyre: Treguesit e Performancës të cilët e justifikojnë Pajtueshmërinë e punës së kontraktorit & pagesën përkatëse për shërbimet e tij.

Bazuar në këtë koncept të përgjithshëm, Mbikqyrësi, i kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, është e nevojshme ta ndihmojë atë në këto çështje :

- Vlerësimin dhe miratimin e mobilizimit dhe organizimit të procedurave të kontraktorit.
- Mbikqyrjen e realizimit të punimeve të rehabilitimit/periodike duke përfshirë testimin për cilësinë e materialeve të përdorur.
- Mbikqyrjen e realizimit të shërbimeve të performancës së rrjetit.
- Mbikqyrjen e përgatitjes për punimet e mirëmbajtjes dimërore.
- Autorizimin e ekzekutimit të punimeve emergjente.
- Kryerjen e inspektimeve formale dhe joformale në rrugë sipas kontratave në bashkëpunim me inspektorët rajonalë dhe përgatitja e proces verbaleve përkatës për çdo segment me mangësitë e evidentuara.



- Në bashkëpunim me inspektorët që ndjekin kontratën nga drejtoritë rajonale, përcaktimin dhe certifikimin e shumave për t'u paguar në baza mujore për punimet e rehabilitimit/periodike dhe të performancës së shërbimeve, duke përfshirë punimet emergjente. Përcaktimi i penaliteteve të dakordësohet me inspektorët rajonalë, përfaqqsues të Drejtive.
- Krijimin dhe menaxhimin e një programi të testimit të cilësisë që do të kryhen në një laborator të pavarur.
- Raportimin mbi aktivitetet e mirëmbajtjes, në bashkëpunim me inspektorët e drejtorisë së rajoneve në Autoritetin Kontraktor, mbi një bazë të rregullt të dhënat.
- Trajnimi i ekspertit të tij, që duhet të mbikqyrin dhe monitorojnë gjithashtu, punimet e Kontraktorit për këtë lloj kontrate.
- Kontrolli i performancës së arritur në mirëmbajtjen dimërore referuar specifikimeve teknike dhe DST.

Për të përmbushur këto kërkesa, Mbikqyrësi i Punimeve do të kryejë një metodologji me detyra të detajuara brenda Propozimit të tij Teknik dhe këto detyra të detajuara do të përfaqësojnë pjesën më të madhe të detyrave të cilat priten të kryhen nga Mbikqyrësi.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

3.1. Përgjegjësitet e përgjithshme

Mbikqyrësi do të ushtrojë të gjithë kujdesin për të mbrojtur interesat e Autoritetit Kontraktor, për të siguruar mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve dhe për të shmangur dukuritë e ç'rregullimeve të trafikut gjatë punës, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Për të garantuar një zbatim në kohë të punimeve dhe përdorimin efikas të burimeve financiare, Mbikqyrësi do të mbajë një prani të vazhdueshme të personelit të tij kyç në vendin e punës.

Mbikqyrësi i Punimeve është përgjegjës për monitorimin 24 orë në 24 orë, në të gjitha ditët e viti dhe dhëni e informacionit në çdo moment ndaj Autoritetit Kontraktor.

Mbikqyrësi do të jetë përgjegjës për verifikimin, në çdo kontratë, që Kontraktori mobilizon dhe mban në vend, të paktën burimet që ai është angazhuar për të siguruar në ofertën e tij dhe që burimet e siguruara janë të mjaftueshme për të mbajtur normat e tij të programuara deri në ditën e përfundimit.

Mbikqyrësi do të jetë përgjegjës për të siguruar që kontraktori përmbush detyrimet e tij për të siguruar raporte mujore të besueshme dhe të plota mbi ecurinë e punimeve, duke theksuar çdo moment shkaqet për vonesat apo ndonjë ç'rregullim tjetër në ecurinë normale të punës. Mbikqyrësi do të mbajë takime të rregullta mujore të progresit, në të cilat Kontraktori duhet të paraqesë raportin e tij mënyrë korrekte. Të gjitha aspektet e Raportit të Progresit do të diskutohen në takimet e Menaxhimit dhe diskutimet do të mbahen në proces-verbal të rregullta dhe kopjet e proces-verbalit do t'i dërgohen edhe inxhinierit të mirëmbajtjes/reabilitimit/periodike të Kontraktorit si dhe Autoritetit Kontraktor. Proses-Verbal duhet të përmbajë veprimet që do të ndërmerr nga të dy palët. Pas kësaj, Mbikqyrësi do të kontrollojë që veprimet, që duhet të ndërmerr nga të dy palët, janë zbatuar në mënyrë korrekte.

3.2 Shërbimet kryesore dhe detyrat që duhen zbatuar



3.2.1 Para dhe me fillimin e Kontratave me Performancë – Mbledhja e të gjithë dokumentacionit të rëndësishëm të Kontratës.

Mbikqyrësi duhet të sigurojë një Plan Pune i cili do të përshkruajë metodologjinë e propozuar në përputhje me Termat e Referencës.

Këtu aktivitetet kryesore, që do të kryhen nga Mbikqyrësi janë të lidhura me miratimet e programeve të Kontraktorëve, materialet dhe teknikat e ndërtimit, të tilla si:

- Shqyrton dhe vërteton garancinë e performancës së kontraktorit.
- Shqyrton dhe vërteton policat e sigurimit të kontraktorit.
- Rishikon listën e organizimit dhe stafit të përgjithshëm të Kontraktorit, duke përfshirë:

- Cilësinë dhe numrin e stafit - pajtueshmërinë me të dhënat, kualifikimet dhe kërkesat.
- Planet e pajisjeve (cilësinë, gjendjen), numrat dhe disponibilitetin, pajtueshmërinë me të dhënat, kualifikimet dhe kërkesat.
- Organizimi/vendndodhja e zyrave dhe depove.
 - Rishikon Programin e Performancës së Kontraktorit
 - Mobilizon Personelin kyç të Kontraktorit
 - Rishikon të dhënat nga Kontraktori të:
 - Planit të Procedurave të Emergjencës dhe Kontigjencës
 - Planit të Menaxhimit të Trafikut
 - Planit të Sigurimit të Cilësisë
 - Planit të Sigurisë së Shëndetit
 - Planit të Mbrojtjes së Ambjentit
 - Planit të Mirëmbajtjes Dimërore

Gjithashtu, përgjegjësia e Mbikqyrësit në këtë fazë do të përfshijë edhe problemet e mëposhtme :

- Verifikimin e ngritjes së kantjerit të kontraktorit dhe mjeteve përkatëse të paraqitura në tender.
- Verifikimin e Nën/Kontraktorëve të propozuar dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Vendosjen e tabelës informative në fillim të një prej segmenteve me të dhënat identifikuuese
- Të vlerësojë përgjegjshmërinë e kontraktorit në masat e menaxhimit të performancës referuar kontratës.
- Propozimet e Kontraktorit për menaxhimin e sigurisë dhe dispozitave të trafikut në rrugë, dhe sigurinë në vendin e punës.
- Propozimet e Kontraktorit për sigurinë operacionale në trafik për përdoruesit e rrugës.
- Planin e Kontraktorit për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Planin e Mirëmbajtjes Dimërore të Kontraktorit.
- Programet e punës të bazuara në burimet e propozuara, dhe programet e përditësuara të punës së Kontraktorit.
- Sasitë dhe llogaritjet e vendosura nga kontraktorët.
- Korrigimi/modifikimet e sondazhit gjeometrik, nëse kërkohet.



- Procedurat për ndërtimin e punimeve të kullimit.
- Origjina e materialeve.
- Teknikat e ndërtimit për strukturat.
- Pregatitjen e dokumentave të menaxhimit të kontratave.
- Krahasimin e punës së kryer në fakt nga ai i paraqitur në propozimin dhe diskutim me Kontraktorin.
- Çdo aktiviteti tjeter në lidhje me miratimin dhe rishikimin e metodave të punës si dhe metodat e menaxhimit.

Kur temat janë për t'u rishikuar, Menaxher i Projektit të Mbikqyrësit ose do t'i pranojë ashtu siç janë ose do të theksojë të gjitha defektet/mangësitë në propozimet e Kontraktorit dhe do të asistojë për të ndihmuar Kontraktorin, sipas nevojës, në përgatitjen e një produkti më të pranueshëm nga kontrata.

3.2.2 Implementimi i Kontratave me Bazë Performancë

Përgjegjësitë e Mbikqyrësit do të përfshijnë, detyrat e mëposhtme:

- Rishikimi i punimeve të planifikuara të Kontraktorit (punimet rehabilituese/periodike), duke identifikuar dhe duke theksuar çdo vend ku punimet e propozuara nuk e bëjnë, apo nuk kanë gjasa për të përbushur kërkesat e kontratës. Ky rishikim do të kryhet në bashkëpunim me inspektorin e drejtorisë rajonale.
- Mbikqyrësit të punimeve i lind e drejta që të miratojë shtyrjen e afatit për kryerjen e punimeve të rehabilitimit/periodike në raste të veçanta, kur kushtet e motit, (siç janë reshjet e tejzgjatura të shiut ose dëborës, temperaturat tejet të ulta ose tejet të larta etj.) nuk lejojnë kryerjen e punimeve specifike ose sipas ligjeve dhe vendimeve respektive për këto çështje.
- Konfirmon Planin e Menaxhimit Mjedisor nga ana e kontraktorit.
- Inspektion dhe kontrollon punimet së bashku me inspektorin përkatës të drejtorisë rajonale në mënyrë që Performance të përbushet sipas specifikimeve dhe skicave.
- Bën ose kërkon nga kontraktori për të kryer testimin e materialeve dhe të punimeve të përfunduara, nga laboratorë të akredituar, si dhe urdhëron zbritjen e sasisë së punimeve të parregullta ose jashtë Kushteve Teknike (që janë në fuqi, bazuar dhe në ligjin Nr. 8402 për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit dhe ndryshimeve përkatëse).
- Rishikon dhe miraton Planin e Sigurimit të Cilësisë të paraqitur nga ana e Kontraktorit dhe kontrollon që ai të zbatohet në përputhje me specifikimet teknike. Në veçanti, Mbikqyrsi duhet të verifikojë që të gjitha analizat laboratorike të përshkruara në aspektin e llojit janë të kryera nga një laborator i Akredituar. Mbikqyrsi do të kontrollojë cilësinë e testeve të tillë me kryerjen e testimit të veçantë (teste ligjore) për të verifikuar gjeljet e kontraktorit.
- Mbikqyr Kontraktorët në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë në punë.
- Mbikqyr Kontraktorët në të gjitha çështjet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.
- Mbikqyr, verifikon dhe saktëson, nëse është e nevojshme, skicat, dhe projektet të Kontraktorit për kryerjen e punimeve të rehabilitimit, periodike dhe emergjente.
- Në bashkëpunim me inspektorin e drejtorisë rajonale i cili mbulon segmentin përkatës, merr, rishikon dhe vërteton deklaratën mujore të hartuar nga ana e kontraktorit.
- Regjistrimi i ditarit të punës sipas ngjarjeve ditore dhe sasitë për t'u paguar (subjekt i testeve gjeometrike dhe të cilësisë).



- Mbikqyr zbatimin nga ana e Kontraktorit të punimeve, duke siguruar që të gjitha kërkesat e projektimit dhe të ndërtimit janë në përputhje me Standartet Shqiptare të Projektimit dhe të Ndërtimit.
- Mbikqyr, hartimin nga ana e kontraktorit, të dhënët e inventarit të të gjithë elementeve të rrugëve në konratë, për dorëzimin në Drejtore të Rajonit.
- Në bashkëpunim me inspektorët e drejtorisë rajonale, vlerëson punimet e përfunduara dhe autorizon pagesat përkatëse në pajtim me kushtet e konratës.
- Mbikqyr përgatitjet për situatën dhe realizimin e punimeve të mirëmbajtjes dimërore.
- Në rast të shtyrjes së datës së përfundimit, përcakton shkaqet për shtyrjen e konratës dhe do t'i raportojë Autoritetit Kontraktor mbi pasojat e një shtyrje të tillë.
- Krijimi i përmbajtjes dhe formatit të një sistemi të raporteve javore nga Kontraktori për inxhinierin e terrenit dhe Mbikqyrësin e Punimeve si dhe informimi i Autoritetit Kontraktor çdo ditë gjatë periudhës dimërore.
- Krijimi i një metodologjje dhe sistemi për fazën e pagesave për punimet fillestare të cilat sigurojnë që këto pagesa janë në përputhje me zbatimin aktual sipas atij të planifikuar.
- Analizon pretendimet e paraqitura nga Kontraktorët dhe raporton mbi kërkesat që janë dorëzuar për mosmarrëveshjen e procedurave.
- Ndrekun dhe kontrollon paraqitjen e pagesave sipas një formulari unik, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, për të gjithë kontraktorët.
- Mbikqyrësi duhet të raportojë menjëherë tek Autoritetit Kontraktor çdo ngjarje apo mosmarrëveshje me kontraktorin e shërbimit të mirëmbajtjes, e cila kërkon ndërhyrjen e tij dhe do të ndihmojë në zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje.
- Në vijim të analizës së tij, ai do të këshillojë inxhinierin e punimeve të Mirëmbajtjes (rehabilitimit ose punimeve periodike) të pasqyrojë qartë skenarët e mundshëm.
- Kontrollon aplikimin e sinjalistikës provizore gjatë kryerjes së punimeve në rrugë.
- Kontrollon vendosjen e tabelës informuese, sipas formatit të miratuar, lidhur me mirëmbajtjen në pikat e fillimit të çdo kontrate.

Mbikqyrësi do të ketë qasje plotësisht për provat e kryera nga Kontraktori, për të ndërmarrë ndonjë testim të kërkuar, me qëllim kontrollin e vërtetësisë së testeve.

Gjatë punimeve të mirëmbajtjes së rrugëve, pagesa e Kontraktorit bëhet mbi bazën e normave të tenderuara për kilometër në muaj për çdo rrugë. Këto pagesa ulen kur nivelet e duhura të shërbimit nuk janë përbushur. Pajtueshmëria me nivelet e shërbimit vlerësohet gjatë inspektimeve të rregullta (jo më pak se një në muaj) formale të kryera bashkërisht nga ana Mbikqyrësit të projektit dhe Kontraktorit, zakonisht menjëherë pas prezantimit nga ana e kontraktorit të deklaratës së tij mujore në mënyrë që të jep informacionin e kërkuar për të verifikuar/korriguar deklaratën.

Detyrat e mësipërme konfirmojnë se Mbikqyrësi do të kryejë detyrat në lidhje me kontrollin e aktiviteteve të mirëmbajtjes si më poshtë :

- Në bashkëpunim me inspektorin e drejtorisë rajonale kryen inspektime joformale, në baza të rregullta, të mjaftueshme për të siguruar që ai është gjithnjë i informuar mbi gjendjen e rrugëve dhe shtrirjen e aktiviteteve të Kontraktorit në të.
- Të informojë Kontraktorin për ndonjë mangësi të vërejtur.
- Merr, rishikon dhe vërteton deklaratën mujore të sjellë nga ana e kontraktorit.
- Koha për kryerjen e Inspektimeve formale, duhet që Kontraktori të njoftohet të paktën 48 orë përpëra, nga ana e Mbikqyrësit.
- Merr raportet e Stafit të Kontraktorit, në lidhje me Inspektimet formale të cilët duhet të mbulojnë të gjitha aspektet e kritereve për nivelet e shërbimit.



- Përgatitja e raporteve të nevojshme të detajuara, për çdo segment rrugor, për të cilin nuk është respektuar koha e dhënë për korrigjin e defekteve.
- Mbikqyr punimet e mirëmbajtjes dimërore.
- Kryen inspektime të tjera formale për të verifikuar veprime korrigjuese aty ku nevojiten.
- Korrigjon ndonjë gabim ose keqinterpretim në deklaratën e Kontraktorit, duke përfshirë edhe sigurinë që të gjitha reduktimet përkatëse janë zbatuar në mënyrë korakte.
- Nënshkruan deklaratën e korrigjuar dhe e paraqet tek Autoritetit Kontraktor për pagesë dhe tek Kontraktori për informacion.
- Merr raportet e ndonjë incidenti lidhur me sigurinë në punë të Kontraktorit dhe sigurohet që gjithë ekipi i Kontraktorit përgatit dhe dorëzon raporte të tillë në kohën e duhur në të gjitha rastet.
- Siguron që të gjithë punimet e mirëmbajtjes kryhen në përpjekje me Planin e miratuar të Menaxhimit të Trafikut.

Mbikqyrja e Punimeve të Emergjencës

Përveç mirëmbajtjes së rrugëve, Kontraktori mund të jetë i detyruar të kryejë ndonjë punë emergjente të nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve në mënyrë që rruga të jetë në një gjendje të kënaqshme. Kontrata përcakton kushtet e punimeve emergjente të cilat janë të kufizuara kryesisht për ngjarje të konsiderueshme të paparashikuara të tillë si rrëshqitjet e mëdha të tokës, dëme të rënda për shkak të kushteve ekstreme të motit etj. Punimet Emergjente ekzekutohen duke ndjekur një “urdhër pune” lëshuar nga Mbikqyrësi.

Mbikqyrësi do të kryejë detyrat e mëposhtme në lidhje me punimet emergjente :

- Në bashkëpunim me inspektorin e drejtorisë së rajonit bie dakord për Punimet emergjente dhe Planin e Kontigjencës të përgatitur nga Kontraktori, brenda 24 orëve.
- Merr çdo kërkesë nga Kontraktori për ekzekutimin e punimeve emergjente, kërkesë e cila shoqërohet me pamje filmike, foto e video.
- E vlerëson kërkesën në bazë të një vizitë në terren brenda 24 orëve;
- Lëshon një urdhër për punimet emergjente, specifikuar si punime për t'u ekzekutuar, sasitë e vlerësuara, shpërblimi (bazuar në normat e punimeve emergjente dhe plotësohet me normat fillestare të punimeve dhe normat e ditëve të punës) dhe kohën e lejuar.
- Merr objeksionet/kundërshtimet e kontraktorit lidhur me urdhërin e punës dhe anulon, ndryshon, modifikon apo konfirmon të njëjtën, brenda 5 ditëve;
- Verifikon ekzekutimin e kënaqshëm të punimeve emergjente; dhe
- Çertifikon shumat e pagueshme në lidhje me punimet emergjente.

3.2.3 Mënyra e Pagesës

- Pagesa e Mbikqyrësit do të bëhet mujore, bazuar në situacionet e paraqitura çdo muaj e cila do të jetë e shoqëruar me:
 - Listë prezenca e stafit, shoqëruar me dokumentacionin që justifikon se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributive të sigurimeve shoqërore, sipas legjislativit të fuqi.
 - Si dhe çdo material justifikues për shpenzimet e paraqitura në situacionin më i ri, sipas (deklarimeve) dokumentave të paraqitura në Tender.
 -



3.2.4 Penalitetet për Mbikqyrësin

- Mosparaqitja në kohë e raporteve apo mos plotësimi i kushteve të përcaktuara më sipër do jetë objekt i aplikimit të penaliteteve, të cilat do të shprehen në zbritje të pagesës ditore të manaxherit të projektit.
- Në rastin e mungesës në objekt të përfaqësuesit të Mbikqyrësit (inxhinierit të terrenit) do të aplikohet gjithashtu penalitet, i shprehur në zbritje të pagesës ditore të manaxherit të projektit.
- Mosparaqitja në kohë e situacionit 30 ditë nga data e përfundimit të punimeve mujore të kontratës respektive të mirëmbajtjes, tarifa ditore e penalitetit do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës së mbikqyrjes por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Ky kriter do të aplikohet në mënyrë kumulative për secilën kontratë mirëmbajtje.
- Përsëritja e tyre do jetë shkak për fillimin e procedurave të ndërprerjes së kontratës.

3.2.5 Pas marrjes në dorëzim të Kontratave të Mirëmbajtjes me Bazë Performance

Pas përfundimit të kontratës dhe deri në fund të periudhës së njoftimit të Defekteve, Mbikqyrësi do të vazhdojë shërbimin. Ai do të hartojë raportin përfundimtar të marrjes në dorëzim dhe ai së bashku me praninë e Autoritetit Kontraktor, do të marrë pjesë në të gjitha inspektimet e nevojshme për qëllimet e kontrollit përfundimtar në rast të ndonjë punimi të mbetur që duhet të përfundojë.

Gjithashtu, ai do të rishikojë procesin e dorëzimit fillestar tek kontraktori, ku objektivi i tij është verifikimi dhe krahasimi me gjendjen ekzistuese të rrjetit në kohën e dorëzimit përfundimtar.

Me përfaqësues nga Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktori, ai do të ndërmarrë inspektime të përbashkëta si më poshtë:

- Jo më vonë se **tre (3) muaj** para përfundimit të kontratës me qëllim të përcaktimit dhe të rënies dakord që punët e kërkua të përfundojnë para fundit të periudhës së kontratës.
- Jo më vonë se **dy (2) muaj** para përfundimit të kontratës me qëllim identifikimin dhe duke u pajtuar për punimet të tjera korriguese që duhet të përfundojnë para fundit të periudhës së kontratës.
- Jo më vonë se **dhjetë (10) ditë** pas përfundimit të kontratës me qëllim konfirmimin se të gjitha punimet e kërkua kanë përfunduar në mënyrë adekuate.
- **Dy muaj para përfundimit** të periudhës së përgjegjësisë së defekteve siç është përcaktuar në kontratë me qëllim të sigurimit që asnje çështje ska lindur gjatë periudhës së mirëmbajtjes së defekteve që mund të parandalojnë lirimin e garancive të performancës të bllokuara.

3.3 Inspektimet

Mbikqyrësi duhet të kryejë inspektime formale dhe joformale për verifikimin e cilësisë së Mirëmbajtjes, të përcaktojë ndonjë mospëlqim dhe të zbatojë reduktimet (penalitetet e parashikuara në specififikimet teknike që shoqërojnë kontratën e mirëmbajtjes me performancë) e pagesave, shkak për mosrespektimin, si dhe të vërtetojë pagesat mujore për Performancën e Shërbimit të Rrjetit.

Ai do të kryejë një seri inspektimesh të rregullta të njëpasnjëshme:



- **Inspektimet e Përgjithshme mujore** për të gjithë gjatësitë e rrjetit. Këto inspektime do të përdoren për të konfirmuar performancën e përgjithshme të kontraktorit, të raportojë mbi gjendjen e përgjithshme të rrjetit ose për të adresuar çështje të veçanta, përdoruesve të rrugës apo publikun e gjerë. Këto inspektime do të ndërmerren bashkërisht me stafin inxhinierik të Autoritetit Kontraktor.
- **Një Inspektim të kombinuar** të gjithë rrjetit në periudhë shirash, reshje bore, natën dhe ditën çdo dy muaj me Menaxherin e Projektit, për të identifikuar çështjet aktuale, kushtet e rrjetit, ecurinë e punimeve të ndryshme dhe për të zgjidhur çështjet që mund të ndikojnë në mirëmbajtjen e rrjetit rrugor. Në ndjekje të përfundimit të çdo inspektimi të kombinuar, Mbikqyrësi do të përgatisë një raport të inspektimit që përbledh rezultatet nga inspektimi me një plan të detajuar veprimi për të adresuar ndonjë çështje të identifikuar.
- **Inspektim për certifikimin e punimeve mujore** si një përbledhje e inspektimeve të shpeshta mujore, me rekomandimet e cilësisë, të cilat do të përfshihen në raportin e veçantë mujor të Mbikqyrësit përfshirë informacionin mbi penalitetet e mbajtura, nëse ka.
- **Inspektim i gjendjes së veprave të artit** i cili do të kryhet të paktën një herë në 6 muaj dhe në çdo rast që do të jetë e arsyeshme dhe sidomos në periudhë reshjesh intensive pas të cilave do të hartohej një raport i detajuar mbi gjendjen, problematikat e konstatuara dhe ndërhyrjet e kryera nga kontraktori i mirëmbajtjes për të gjithë elementët përbërës. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet urave sipas inventarit përkatës.

Mbikqyrësi do të inspektojë dhe vlerësojë çdo propozim të Kontraktorit gjatë ose menjëherë pas ngjarjeve të përcaktuara si emergjente. Këto inspektime janë të nevojshme për të verifikuar shkallën e çdo dëmi si pasojë e ngjarjes emergjente, për të përcaktuar vlerësimet e kostove të riparimit dhe të ndihmojë me koordinimin e burimeve të Kontraktorit në rehabilitimin e rrjetit sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas ngjarjes së deklaruar.

3.4 Raportet

Mbikqyrësi do të plotësojë kërkesat e mëposhtme të raportimit për secilën kontratë:

a. Raporti fillestar

Brenda 30 ditëve të fillimit të Shërbimit, ai do të paraqesë të plotë e të detajuar, marrëveshjet e tij për punën e mbikqyrjes, duke përfshirë një plan të detajuar implementimi, konfirmimin e stafit inxhinierik me organizimin e tij të përgjithshëm. Ky raport do ti bëhet i ditur kontraktorëve dhe Autoritetit Kontraktor.

b. Ditari i objektit deri ditën e përfundimit

Ai do të jetë në dispozicion për inspektim në çdo kohë nga stafi i Autoritetit Kontraktor dhe auditimet zyrtare dhe do të përfshijë:

- Aktivitetet që duhen bërë dhe parametrat që duhet të maten dhe vendet nga ku do të mblidhen mostrat ose matjet e marra për ditë të veçanta.
- Aktivitetet e bëra dhe parametrat e matur në vendet nga ku janë mbledhur mostra
- Udhëzimet, rekomandimet dhe urdhrat e dhëna Kontraktorit dhe veprimet e ndërmarra nga kontraktori në një përgjigje të tyre.

c. Raportet Mujoë Progresivë dhe Raportet Progresivë Periodikë



Mbikqyrësi do të sigurojë raporte mujore dhe periodike progresive për dorëzimin në Autoritetin Kontraktor, të cilët do të përbledhin të gjitha aktivitetet administrative dhe mbikëqyrëse të ndërmarra nga Mbikqyrësi gjatë periudhës së përcaktuar. Çdo raport do të përfshijë detajet e statusit aktual të përfundimit të projektit dhe do të mbulojë gjendjen financiare, orarin e progresit dhe datat e parashikuara të përfundimit për komponentë të ndryshëm të projektit.

Formati i raporteve mujore dhe periodike, do të miratohet nga Autoritetit Kontraktor dhe do të përfshijë në përgjithësi, si më poshtë:

- Listat dhe përshkrimet e detajuara të progresit mujore dhe punimet kumulative për secilën kontratë, duke përfshirë skicat (nëse është e nevojshme) dhe dokumentacionin teknik, identifikimin e vonesave dhe rekomandimet për veprimet e ardhshme të mundshme;
- Të ardhurat mujore, shpenzimet dhe evidencën për çdo kontratë, duke përfshirë detajet financiare të kërkesave të synuara apo të dakordësuara dhe zgjatjet kohore ose ndonjë gjë tjetër e cila mund të ndikojë në koston e punës.
- Situacionet mujore të Kontraktorit duhet të çertifikohen dhe paraqiten brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve mujore të kontratës respektive.
- Penaliteti për çdo ditë vonesë pas mbarimit të afatit 30 ditor për paraqitjen e situacionit do të aplikohet penaliteti për çdo ditë vonesë, mbi pagën e Menaxherit të projektit
- Detajet e çdo skice apo problemet e kontrollit të cilësisë, kopjet e dokumenteve të sigurimit të cilësisë, rezultatet e testit dhe çertifikatat e materialeve të përfshira.
- Detajet e çfarëdo aspekti nga i cili mund të kärcënhet përfundimi i kontratave, si dhe masat e marra (ose që do të merren) të miratuara për të kapërcyer aspekte të tillë;
- Të dhënrat e nevojshme statistikore, duke përfshirë detajet e çdo incidenti të rezikshëm.
- Pajtueshmëria me Planin e Menaxhimit Mjedisor.
- Informacione të tjera për të rënë dakord me Autoritetin Kontraktues.

Raportet mujore dhe periodike duhet të përfshijnë detajet e mëposhtëm :

- Detajet e aktiviteteve të kryera gjatë muajit dhe sasitë e punës së përmbushur,
- Fotografitë e terrenit,
- Grafikët e progresit fizik (aktuale dhe të planifikuara),
- Detajet e problemeve dhe veprimeve të propozuara,
- Listat e progresit financier (aktuale dhe të planifikuara),
- Detajet e kërkesave kontraktorëve të mbetur pezull dhe miratuar,
- Detajet e ndryshimeve të miratuar,
- Përbledhje e testeve materiale gjatë muajit,
- Përshkrimi i kushteve të motit,
- Pajtueshmëria në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale,
- Aktivitetet kritike për muajin e ardhshëm.

Raportet mujore duhet të përfshijnë edhe :

- Raportet e problemeve mujore, përpara shpërndarjes së faturave të përkohëshme me komentet mbi cilësinë e punimeve të kryera.
- Të nxjerrë raporte individuale nëse është e domosdoshme,
- Nxjerra e raporteve shtesë për kërkesën e Rehabilitimit dhe /ose Mirëmbajtjen;



– Raportet në lidhje me cilësinë e vërejtur të punëve të ekzekutuara dhe të rekmandojë veprimet që duhen ndërmarrë në rast të rezultateve të pakënaqshme

Përveç nga detyrat e tij, siç u përmendën, gjatë korrespondencës dhe rishikimit të punëve që do të kryhen do të jetë e nevojshme të përgatiten :

e. Raporti i kompletuar i punimeve të Rehabilitimit/Periodike,

Ku do të pasqyrohen qartë punimet e kryera gjatë periudhës së parë 12-mujore shoqëruar me pamje filmike dhe foto.

g. Raporti Final në përfundimin e kompletimit të Kontratës së Mbikqyrësit

Mbikqyrësi do të përgatisë një Raport Final pas kompletimit final të kontratave të mirëmbajtjes me Bazë Performance. Ky raport do të përbledhë historinë e punimeve fizike dhe financiare për çdo kontratë. Gjithashtu ai do të përfshijë dhe listën e defekteve të identifikuara gjatë punimeve dhe instrukzionet e dhëna kontraktorit gjatë periudhës së Garancisë së defekteve për punimet e riparimit dhe detajet për ndonjë problem të ngelur pezull.

Ky raport do të përfshijë detajet për ndonjë problem me interes të veçantë, shembujt e materialeve të rinj të përdorur dhe metodat e testimit ose të rikonstruksionit.

Gjithashtu duhet të përfshihet edhe një përbledhje e veprimeve të ndërmarra në lidhje me ambjentin.

Siç përmendet edhe më lart, ky raport do të përfshijë detajet e metodave të ndërtimit të ndërmarra nga Kontraktori me të dhënat siç është ndërtuar duke treguar vendndodhjen, detajet e punëve të kryera, grafikët e defekteve aprovimet e korrigjimeve të ndërmarra dhe përbledhjen e zbatimit të Planit të Menaxhimit të Ambjentit.

Rekomandimet gjithashtu do të bëhen në lidhje me ndonjë kërkësë shtesë për punimet e rehabilitimit ose asistencën teknike e cila mund të jetë identifikuar nga Mbikqyrësi që është konsideruar si e nevojshme për projektin në të ardhmen.

Së fundmi, Mbikqyrësi do të përfshijë një vlerësim të aspekteve të suksesëshme të vlerësuara së bashku me një rishikim kritik të këtyre aspekteve të cilat mund të janë problematik dhe që mund të merren në konsideratë për projektet e ardhshme.

4. Kohëzgjatja e Kontratës

4.1. Kohëzgjatja e Kontratës

Aktiviteti i Mbikqyrësit do të vazhdojë paralel me aktivitetin e Kontraktorit për mirëmbajtjen e rrugës, (rehabilitimin/periodike, mirëmbajtjen rutinë dhe punimet emergjente) për Drejtorinë e Rajonit.

Zgjatja totale e Kontratës së Shërbimit të Mbikqyrjes do të jetë **4 vjet (pra 48 muaj)**. *Vetëm për Menaxherin e Rajonit do të jetë 4 vjet e 1 muaj (pra 49 muaj)*. Muaji pas përfundimit të kontratës së implementimit të mirëmbajtjes nga kompanitë, do të shërbejë për kontrollin e kërkësës përfundimtare të pagesës dhe përgatitjen e raportit përfundimtar nga ana e Menaxherëve të Rajoneve.



5.1. Personeli

Mbikqyrësi duhet të sigurojë një ekip me përvojë në mbikëqyrje të kontratës së mirëmbajtjes, i cili të jetë një kombinim i specialistëve të lartë të stafit me kompetencën teknike dhe menaxheriale të provuar dhe me përvojë.

Gjuha e komunikimit në të gjithë dokumentacionet do të jetë gjuha shqipe.

Personeli Kyç

Duke marrë në konsideratë punën që do të kryhet nëpërmjet këtyre kontratave, Mbikqyrësi duhet të sigurojë, stafin e mëposhtëm kyç :

- 1. Nje (1) Menaxher Projekti për Rajonin me kohë të plotë (49 muaj)** – Inxhinier rrugësh me përvojë, dhjetë (10) vite përvojë në projekte inxhinierike civile, duke përfshirë të paktën katër (4) vjet eksperiencë në Mbikqyrje për mirëmbajtjen e rrugëve ose mbikqyrje punime rrugore.

Udhëheqësi i ekipit do të ketë përgjegjësi të menaxhimit të projektit të përgjithshëm dhe të përbushë rolin e Menaxherit të Projektit, siç kerkohet. Përveç mbikëqyrjes dhe administrimit të mirëmbajtjes së rrugëve, ai duhet të jetë kompetent për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procedurave të testimit të kontratave të kontraktorit, të vlerësojë kërkesat e projektimit, dhe po qe e nevojshme të bëjë edhe zëvendësimin e projekteve. Ai do të jetë përgjegjës për administratën qendrore dhe të bashkëpunojë me inxhinierët e Autoritetit Kontraktor. Ai pritet të jetë i instaluar në një zyrë qëndrore, brenda territorit të Rajonit përkatës, për lehtësimin e koordinimit me Autoritetit Kontraktor dhe detyrat e tij do të përfshijnë proceset si më poshtë:

- Organizimin e personelit (inxhinierëve të terrenit) dhe caktimin e mbikëqyrjes së të gjitha mirëmbajtjeve, periodike dhe punimet rehabilituese nga kontraktorët, përcaktimin e kërkesave të ndryshme për mbikëqyrjen që ekziston në mirëmbajtjen me bazë performance në krahasim me llojet e tjera të punimeve.
- Të bëjë riprogramimin e nevojshme dhe rialokimin e stafit mbikëqyrës (inxhinierëve të terrenit) për të përbushur ndryshimet në performancën e kontratave dhe ngarkesës së punës.
- Monitorimin, paraqitjen dhe vlerësimin e raporteve. Të përgatisë dhe dorëzojë raporte dhe informacione Koordinatorit të projektit në Autoritetin Kontraktor.
- Të propozojë një plan trajnimi për personelin e punësuar në këtë projekt.
- Të mbajë dhe të përditësojë grafikun që mbulon të gjitha kontratat e mirëmbajtjes dhe punimet e rehabilitimit, duke parashikuar performancen e duhur sipas nivelit të shërbimit.
- Të përgatisë dhe të paraqesë informacione rregullisht në Autoritetin Kontraktor.
- Të iniciojë dhe planifikojë takimet mes Autoritetin Kontraktor dhe përfaqësuesve të kontraktorëve.
 - Asiston Autoritetin Kontraktor për preqatitjen e dokumentave për procedurat e reja që do të lidhen për kontratat e mirëmbajtjes. Asistenca konsiston në informacionin për llojet dhe sasitë e punimeve, në përputhje me zërat e manualit



të çmimeve në fuqi, që kërkon i gjithë rrjeti rrugor në administrim, (punime të cilat nuk kanë mundur të realizohen nga kontratat ekzistuese), për sjelljen e tij në një gjendje të pranueshme për mirëmbajtje.

- Aprovon grafikët e punës për stafin mbikqyrës. Bën ndryshime në këto grafikë, nëse është e nevojëshme, gjatë ndryshimeve të bëra në aktivitetet e mirëmbajtjes së Kontraktorit.
- Kontrollon dhe bën rekomandime në Planet e kontraktorit.
- Është përgjegjës për inspektimet e përbashkëta mujore për punimet periodike të kryera nga Kontraktori.
- Llogarit dhe rekomandon zbritjet/penalitetet gjatë dështimit të punimeve nga ana e Kontraktorit.
- Kontrollon, korrigjon dhe bën rekomandimet inxhinierëve të terrenit lidhur me vendimet e tyre, shqetësimet, problemet për aprovimet e çertifikatave mujore të pagesave, ankesat si dhe pagesat për urdhërat e punimeve shtesë dhe/ose ndryshon urdhërat e dhëna më parë.
- Eshtë përgjegjës për raportimin e progresit të projektit.
- Merr pjesë në takimet që bëhen midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor. Informon inxhinierët e terrenit rrëth orës dhe axhendës së takimeve dhe kërkon pjesëmarrjen e tyre. Siguron që këtu të jetë pjesmarrës edhe stafi tjetër ose ekspertët në rastet kur është e nevojshme dhe kur paraqiten probleme për zgjidhje.
- Asiston në negociatat ndërmjet inxhinierëve të terrenit dhe Kontraktorëve.
- Asiston në takimet ndërmjet inxhinierëve të terrenit me Autoritetet Lokale dhe palëve të tjera të interesuara.
- Miraton shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve të rehabilitimit, për arsyen madhore që mund të jenë kushte jo të përshtatëshme të motit për një periudhë të gjatë kohore ose gjendje emergjence të shpallur nga Qeveria.
- Merr pjesë në planifikimin dhe caktimin e punës së kontraktorit me këshilla, rekomandime, bazuar në specifikimet etj, miraton planet dhe oraret në bashkëpunim.
- Monitorimin, paraqitjen dhe vlerësimin e raporteve. Të përgatisë dhe dorëzojë raporte dhe informacione për Autoritetin Kontraktor sa herë që ky i fundit i kërkon.
- Investigon ndryshimet në projekt dhe masat e propozuara nga Kontraktori.
- Bën rekomandime dhe merr pjesë në negociata, çështje dhe/ose aprovimin e urdhërave të punës dhe ndryshon urdhërat në sajë të kushteve të paparashikuara të një moti jo normal, kërkesave shtesë etj.
- Merr veprime legale kur kërkohet të korrigohen aktivitetet e paligjshme, vjedhja, keqpërdorimi apo dëmtimi i rrugëve dhe pajisjeve rrugore e tjera dhe ndjek rrugën ligjore për ndalimin e këtyre keqpërdorimeve.
- Kontrollon, korrigjon dhe bën rekomandimet për shqetësimet lidhur me çertifikatat mujore të pagesave të kontraktorit si dhe pagesat e punimeve shtesë apo urdhërave të punës të ndryshuar të sjella nga inxhinierët e terrenit.
- Investigon dhe kontrollon rastet e punimeve emergjente dhe jep zgjidhjet për to.
- Kontrollon dhe miraton planet e sjella nga inxhinierët e terrenit lidhur me grafikët e punës, kryerjen e punimeve shtesë e tjera.

2. Inxhinier për rrugët në çdo kontratë

Për rajon



3 inxhinierë terreni me kohë të plotë 48 muaj:

- Ata duhet në mënyrë preferenciale të kenë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë në projektet e zbatimit të rrugëve, duke përfshirë të paktën 4 (katër) vite ekperiençë në punët e mirëmbajtjes ose mbikqyrje punime rrugore, dhe detyrat e tyre do të përfshijnë:
 - Së bashku me Menaxherin e Rajonit të organizojë dhe të kryejë mbikëqyrjen e të gjitha punëve të mirëmbajtjes bërë nga Kontraktorët,
 - Së bashku me Menaxherin e Rajonit, merr pjesë në planifikimin dhe caktimin e punës së kontraktorit me këshilla, rekomandime, bazuar në specififikimet etj. Miraton planet dhe oraret e realizimit dhe implementimit të punimeve në bashkëpunim me Menaxherin e Rajonit,
 - Investigon ndryshimet në projekt dhe masat e propozuara nga Kontraktori. Në varësi të shtrirjes dhe rëndësise së ndryshimeve rastet e diskutueshme duhet të përcillen tek Menaxheri i Rajonit për marrjen e vendimit.
 - Është përgjegjës për cilësinë dhe korrektësinë në kontrollin e gjithë llojeve dhe sasisë së punimeve.
 - Kontrollon raportet e marra nga Kontraktori dhe ja paraqet ato Menaxherit të Rajonit
 - Propozon aksionet legale kur kërkohet të korrigohen aktivitetet e paligjshme, vjedhja, keqpërdorimi apo dëmtimi i rrugëve dhe pajisjeve rrugore e tjera.
 - Mbështet Menaxherin e Rajonit në kontrollin, korrigjinin dhe bën rekomandimet për shqetësimet lidhur me certifikatat mujore të pagesave të kontraktorit si dhe pagesat e punimeve shtesë apo urdhërave të punës të ndryshuar.
 - Ndërpert punimet e kryera nga kontraktori i mirëmbajtjes, nëse është e nevojshme, për shkak të pajisjeve dhe makinerive të pamjaftueshme, metodat e gabuara të punës apo materiale jashtë cilësisë derisa të bëhen korrigjimet e duhura.
 - Ndërhyn dhe ndalon aktivitetet të cilat rrezikojnë sigurinë në trafik, deri sa të merren masat e duhura për sigurinë rrugore dhe sigurimin e trafikut.
 - Inicion në mënyrë të menjëherëshme punimet e emergjencës për shkak të aksidenteve, rrëshqitjeve të tokës apo situatave katastrofike në mënyrë që të kufizohen dëmet e mëtejshme të njerëzve, rrugëve dhe mjedisit.

3. Një (1) inxhinier mjedis me kohë të pjesëshme 8 muaj, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

- Inxhinieri mjedisit do të jetë prezent sa herë që Menaxheri i Rajonit do të kërkojë prezencën e tij.
- Ai është përgjegjës për miratimin e Planit të Mbrojtjes së Ambjentit dhe mënyrën e zbatimit të tij.
- Ai përgatit Raportet lidhur me mbrojtjen e mjedisit, dhe i paraqet ato tek Menaxheri i Projektit, i cili ja bashkëngjitet çdo 6 muaj Raportit të tij që paraqet në Autoritetit Kontraktor.

1. Një (1) inxhinier gjeolog/ gjeoteknik me kohë të pjesëshme 8 muaj për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

- Inxhinieri gjeolog do të jetë disponibël sa herë që Menaxheri i Rajonit do të kërkojë prezencën e tij.



- Të japë vlerësimet e tij për rrëshqitjet, qëndrueshmërinë e skarpatave, masat inxhinierike që duhen marrë, hidrologjinë dhe probleme të tjera që lidhen me gjeologjinë e rrugëve, veprat e artit etj.

2. Një (1) inxhinier për sigurinë rrugore (me çertifikatë "Auditues/Inspektues të sigurisë rrugore") me kohë të pjesëshme 6 muaj, gjithë kohën e zgjatjes së kontratës.

- Ai do të jetë përgjegjës për miratimin e Planit të Menaxhimit të Trafikut.
- Do të kryej inspektime (brenda 6 majorit të parë të projektit) në të gjithë segmentet rrugorë për të evidentuar problematikat lidhur me sigurinë rrugore dhe me një raport për ndërhyrjet që propozon dhe i paraqet tek Menaxheri i Projektit.
- Sa herë që kryhen punime rehabilitimi ose emergjente në rrugë, do të kontrollojë aplikimin e skemave provizore nëse janë në përputhshmëri me skemat e përkohshme.
- Do të jetë prezent gjatë kryerjes së punimeve rehabilituese që lidhen me sinjalistikën dhe pajisjet e sigurisë rrugore.
- Paraqet tek Menaxheri i Rajonit dakortësinë/mosdakortësinë për mënyrën e kryerjes së punimeve.

5.2. Mbështetja e Personelit, Pajisjet dhe Objektet që do të ofrohen nga Mbikqyrësi

Pikat e mëposhtme do të sigurohen nga Mbikqyrësi:

(i) **Zyra / sipas Kontratës (1 për Rajon) me sipërfaqe rreth 100 m²**, duke përfshirë qera zyre, orendi zyre, mirëmbajtjen, sigurinë, dhe objektet e komunikimit dhe internetit, në një caktim kohe të plotë të Kontratës.

(ii) **1 automjet, Makinë Tip 4x4 për Menaxherin e Projektit për Rajon** (ku llogaritet qeraja e marrjes, lënda djegëse dhe mirëmbajtje automjeteve, në caktimin kohë të plotë të kontratës, **48+1 muaj**).

(iii) **automjetet për inxhinieret e terrenit , Makinë Tip 4x4** (ku llogaritet qeraja e marrjes, lënda djegëse dhe mirëmbajtje automjeteve, në caktimin kohë të plotë të kontratës, për sejcilin rajon do jenë si më poshtë :

- Makina Tip 4*4 , copë – 3 për inxhinierët e terrenit me kohëzgjatje **48 muaj**

Formulari Teknik Nr. 1– Stafi dhe Facilitetet

Komentoni këtu stafin dhe objektet që do të ofrohen nga Klienti duke përfshirë:

- Curriculum vitae për stafin
- Mbështetjen administrative
- Hapësirat për zyrat
- Transportin
- Pajisjet e tjera



Formulari Teknik Nr. 2 Përshkrimi i metodës, metodologjia dhe plani i punës për kryerjen e detyrës

Qasja teknike, metodologjia dhe plani i punës janë komponentet kryesore të Propozimit Teknik. Propozimi juaj Teknik duhet të konsistojë në një propozim përfshirës me paraqitje grafike dhe diagrame, të ndara në tre kapituj në vijim:

- a) Qasja teknike dhe Metodologjia,
- b) Plani i punës, dhe
- c) Organizimi dhe Stafi,

a) Qasja teknike dhe metodologjia. Në këtë capitull ju duhet të shpjegoni kuptimin tuaj të objektivave të detyrës, qasja në shërbimet, metodologjia për kryerjen e aktiviteteve dhe pritshmërinë, dhe shkallën e detajeve të perdonura. Ju duhet të nxirni në pah problemet duke u adresuar dhe rëndësinë e tyre, dhe të shpjegoni qasjen teknike që do të adoptoni për trajtimin e tyre. Ju gjithashtu duhet të shpjegoni metodologjitet që propozoni për të miratuar dhe nxjerrë në pah përputhshmërinë e këtyre metodologjive me qasjen e propozuar.

b) Plani i punës. Në këtë capitull ju duhet të propozoni aktivitetet kryesore të detyrës, përmbytjen e tyre dhe kohëzgjatjen, shkrirjen dhe ndërlidhjet, piketa (duke përfshirë miratimet e përkohshme nga klienti), dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i propozuar i punës duhet të jetë në përpunhje me qasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar kuptimin e TOR dhe aftësinë përkthyer ato në një plan të mundshme të punës. Një listë e dokumenteve përfundimtare, përfshirë raportet, vizatimet, dhe tabelat që do të dërgohen si prodhim final, duhet të përfshihen këtu.

c) Organizimi dhe Stafi. Në këtë capitull ju duhet të propozojë strukturën dhe përbërjen e ekipoit tuaj. Ju duhet të listoni disiplinat kryesore të detyrës, eksperti kryesor përgjegjës, dhe propozoni stafin teknik dhe atë mbështetes.

Formulari 3 - Përbërja e ekipoit dhe detyrat



Formulari 4 – Grafiku i punës



Autoriteti Rrugor Shqiptar

Rruja Sami Frashëri, Nr.33, Tiranë. Email:info@arrsh.gov.al Tel: 04 222 3600